



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 06

Datë: 08.02.2022: Ora: 13:30

Vendi: Vendi: Mali Robit (Durrës).

Kryesues: Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Rifat Krasniq Fazli Stollaj.

SKQZ: Sekretariati: Burim Ahmetaj – Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ- së, Xhemail Peçani, i Zyres Ligjore, Valmira Selmani u. d. Drejtor Ekzekutiv i ZRPPC.

Përkthyes: Argjina Misini.

RENDI I DITËS

1. 1.Hyrje, z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2.Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore:.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal, në komunat: Prishtine, Gjilan dhe Pejë.

4.Të ndryshme.

2. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi, e kryesoi mbledhjen e 6-të të KQZ-së të mbajtur përgjatë punëtorisë së KQZ-së në Durrës. Në këtë mbledhje, fillimisht u miratua rendi i ditës, si dhe procesverbali nga mbledhja nr. 05/2022.

3. Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Çështje Ligjore:.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal, në Komunat: Prishtinë, Gjilan dhe Pejë:

Sami Kurteshi, tha se Këshilli për Çështje Ligjore, ka shqyrtuar kërkesat lidhur me zëvendësimet e anëtarëve të kuvendeve komunale në Prishtinë, Gjilan dhe Pejë. Pas pranimit të kërkesave për zëvendësime, bazuar në rregullativën ligjore, aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese, të Ligjit për Zgjedhjet, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësime, kandidatët i kanë plotësuar kushtet për zëvendësim.

Zyra ligjore, rekomandon të bëhen këto zëvendësime nga KQZ.

Kreshnik Radoniqi: I dëgjuam arsyetimet e zyrës ligjore, si dhe rekomandimet. Sipas komunave, do t'i lexoj zëvendësimet dhe pastaj, ne t'i votojmë me radhë:

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Prishtinës, Ilirik Musliu, zëvendësohet nga Liridon Selmani nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Miratohet në mënyrë unanime.

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Prishtinës, Plator Gërdovci, zëvendësohet nga Flamur Dërvishi nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Miratohet në mënyrë unanime.

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Prishtinës, Besianë Musmurati, zëvendësohet nga Gresa Lahu nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Miratohet në mënyrë unanime.

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Gjilanit, Bajram Isufi, zëvendësohet nga Ekrem Kryeziu nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Miratohet në mënyrë unanime.

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Gjilanit, Leonora Morina-Bunjaku, zëvendësohet nga Erestina Isufi nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Miratohet në mënyrë unanime.

4. Të ndryshme !

Për KQZ

Kryetari, z. Kreshnik Radoniqi
